

20200180328

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR AGJENCI PRIVATE PËR PUNËSIM

Neni 1

Në Ligjin për për Agjenci Private për Punësim “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 113/18), në nenin 34 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

“(3) Agjencia Private për Punësim me licencë për ndërmjetësim për punësim, nuk mund të arkëtojë kompensim për shërbimet për ndërmjetësim nga personi i dërguar për punësim të mundshëm të punëdhënësi.“.

Neni 2

Në titullin e kreut “V. EDUKIMI DHE DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE” fjalët: “EDUKIM DHE” shlyhen.

Nëntitulli para nenit 41 “Edukimi” shlyhet.

Neni 3

Neni 41 ndryshohet si vijon:

“(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i punës konstaton që subjekti i mbikëqyrjes inspektuese ka kryer kundërvajtje të përcaktuar në nenet 42, 43, 44, 45, 46, 47 dhe 48 të këtij ligji, është i obliguar për parregullsinë e kryer dhe kundërvajtjen e kryer të përpilojë procesverbal, në pajtim me ligj dhe me aktvendim subjektit të mbikëqyrjes inspektuese t’i shqiptojë masë inspektuese vërejtje dhe t’i përcaktojë afat në të cilin është i obliguar t’i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë.

(2) Nëse pas kalimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori konstaton që parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjeluar, me aktvendim shqipton masë inspektuese urdhër për shkak të mënjanimin të parregullsive dhe mangësive të konstatuara.

(3) Aktvendimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, miratohet menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditëve nga dita e përpilimit të procesverbalit, në pajtim me ligjin.

(4) Kur gjatë mbikëqyrjes inspektuese nuk janë konstatuar parregullsi dhe shkelje tjera të ligjit apo ndonjë dispozite tjetër apo parregullsitë e konstatuara janë mënjeluar gjatë mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori e ndërpret procedurën me konstatim në procesverbal në pajtim me ligjin.

(5) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë të shënuar në procesverbal në pajtim me ligjin.

(6) Në rastin nga paragrafi (5) të këtij neni, inspektori është i obliguar menjëherë, ndërkaq më së voni në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, të miratojë aktvendim me gojë për shqiptim të masës inspektuese.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafët (1), (2) dhe (6) të këtij neni, mund të parashtrahet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në organin kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin.

(8) Ankesa nga paragrafi (7) i këtij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit nga paragrafët (1), (2) dhe (6) të këtij neni.

(9) Për paralajmërimet e shqiptuara, organi kompetent inspektues mban evidencë, në mënyrë të përcaktuar nga ministri kompetent për çështje nga fusha e punës.“.

Neni 4

Neni 42 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël - person juridik, gjobë në shumë prej 500 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm - person juridik dhe gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh - person juridik, nëse:

- ka lidhur më shumë marrëveshje aktive për punësime të përkohshme nga numri i paraparë në pajtim me licencën për lidhje të marrëveshjeve të cilën e posedon (neni 7 paragrafi (3)),

- e zvogëlon numrin e të punësuarve, në pajtim me nenin 9 të këtij ligji ose numrin e zvogëluar të të punësuarve nuk e plotëson në afat më të gjatë se 15 ditë (neni 15 paragrafi (1) alineja 3),

- agjencia private për punësim kryen veprimtari në kundërshtim të veprimtarisë për të cilën është lëshuar leja (neni 15 paragrafi (1) alineja 4 të këtij ligji),

- agjencia private për punësim të punësuarve nuk u paguan rogë dhe kompensime të rogës, tre muaj nga dita e ndodhjes së detyrimit (neni 15 paragrafi 1 alineja 7 të këtij ligji),

- në marrëveshjen për punësim me punëtorin e përkohshëm të agjencisë, vendos dispozitë me të cilën ndalohet ose pengohet lidhje e marrëveshjes për punësim ndërmjet punëtorit të përkohshëm të agjencisë dhe punëdhënësit shfrytëzues (neni 22 i këtij ligji),

- lidh marrëveshje për punësim me punëtorin e përkohshëm të agjencisë për punë të njëjta të përkohshme me ndërprerje ose pa ndërprerje në afat më të gjatë nga ai i paraparë me këtë ligj (neni 24 paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji),

- paguan kompensim për shërbimet nga punëtorët e përkohshëm të agjencisë për punësimin e kryer (neni 25 paragrafi (2) të këtij ligji),

- nuk lidh marrëveshje për kalimkalim të punëtorëve të përkohshëm të agjencisë, nuk e lidh në formë të shkruar dhe nuk rruan ekzemplar nga i njëjti në hapësirat e veta të punës në të cilat është regjistruar selia e agjencisë private për punësim dhe të punëdhënësit shfrytëzues (neni 26 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji),

- marrëveshja për kalimkalimin e punëtorit e lidhur me punëdhënësin shfrytëzues detyrimisht nuk i përmban të dhënat e parapara në pajtim me këtë ligj (neni 26 paragrafi (4) i këtij ligji),

- lidh marrëveshje për kalim të punëtorit të përkohshëm të agjencisë në kundërshtim me këtë ligj (neni 26 paragrafi (5) alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji),

- nuk përgatit dhe nuk dorëzon përlllogaritje të posaçme për rogë dhe kompensime të rogës për punëtorët e punësuar të agjencisë të punëdhënësi shfrytëzues për secilin punëdhënësi shfrytëzues individual dhe për të punësuarit në agjenci private për punësim me licencë për punësime të përkohshme, individualisht (neni 27 paragrafi (1) të këtij ligji),

- nuk i paguan rogë dhe kompensime të rogës punëtorit të kaluar të përkohshëm të agjencisë ditën e parë të punës nga dita e pagesës së mjeteve nga punëdhënësi shfrytëzues (neni 27 paragrafi (2) të këtij ligji),

- nuk i paguan detyrimet për punë dhe kompensimet e punës sipas punëtorit të kaluar të përkohshëm të agjencisë, përkatësisht nëse punëdhënësi shfrytëzues nuk paguan një faturë ndaj agjencisë private për punësim (neni 28 i këtij ligji),

- nuk lidh marrëveshje për punësim me punëtorin para kalimit të punëtorit të punëdhënësi shfrytëzues në pajtim me dispozitat nga sfera e marrëdhënieve të punës (neni 29 paragrafi (1) të këtij ligji),

- lidh marrëveshje për punësim me punëtorin i cili kalon te punëdhënësit shfrytëzues, pa i përmbajtur të gjitha elementet e përcaktuara me këtë ligj (neni 29 paragrafi (2) të këtij ligji);

- lidh marrëveshje për punëtorin e përkohshëm të agjencisë me rogë bazë më të vogël nga roga bazë e punëtorit të punëdhënësi shfrytëzues i cili punon në punë të njëjta, kurse nëse nuk ka të tillë, i cili punon në punë të ngjashme (neni 30 paragrafi (1) të këtij ligji),

- e prish marrëveshjen për punësim me punëtorin e përkohshëm të agjencisë në afat tjetër të lëshimit nga puna nga afati i lëshimit nga puna i përcaktuar me këtë ligj (neni 33 paragrafi (1) të këtij ligji) dhe

- ia prish marrëveshjen për punësim punëtorit të përkohshëm të agjencisë para kalimit të afatit të përcaktuar në marrëveshje për shkak të pushimit të nevojës për punëtor të përkohshëm të agjencisë të punëdhënësit shfrytëzues, përveç në rast të tërmetit, zjarrit, vërshimeve dhe fatkeqësive tjera elementare (neni 33 paragrafi (2) të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënës mikro dhe i vogël, 300 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënës i mesëm dhe 400 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënës i madh.“

Neni 5

Neni 43 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 150 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël - person juridik, gjobë në shumë prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm - person juridik dhe gjobë në shumë prej 400 deri 600 në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh - person juridik, nëse:

- nuk e njofton ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës për hapjen e filialit në afat prej pesë ditësh nga dita e hapjes (neni 9 paragrafi (7) të këtij ligji),

- gjatë pushimit të licencës, në pajtim me këtë ligj, nuk i ç'lajmëron punëtorët e përkohshëm të agjencisë (neni 16 paragrafi (2) të këtij ligji) dhe

- kalon punëtor të përkohshëm të agjencisë te punëdhënësi shfrytëzues, pa pasur marrëveshje të lidhur për punësim (neni 18 paragrafi (1) alineja 2 të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënës mikro dhe i vogël, 250 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënës i mesëm dhe 350 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënës i madh.”

Neni 6

Neni 44 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël - person juridik, gjobë në shumë prej 500 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm - person juridik dhe gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh - person juridik, nëse:

- nuk siguron kushte të njëjta për punën dhe punësimin e punëtorëve të kaluar të përkohshëm të agjencisë si për të punësuarit e vet (neni 19 i këtij ligji),

- nuk i informon punëtorët e përkohshëm të agjencisë për shpalljet e veta të publikuara për vende të lira të punës me theksimin e konkursit publik në vend të dukshëm në hapësirat e veta të punës, me postë elektronike ose SMS porosi (neni 21 paragrafi (1) të këtij ligji),

- nuk siguron qasje të barabartë të punëtorëve të përkohshëm të agjencisë për trajnimet e parapara si për të punësuarit e vet (neni 21 paragrafi (2) të këtij ligji),

- lidh marrëveshje për kalim të punëtorit me punëdhënësin shfrytëzues, në kundërshtim me këtë ligj (neni 24 paragrafi (1) alinetë 1 deri 6 të këtij ligji),

- ekzemplar nga çdo marrëveshje e lidhur për kalimin e punëtorëve të përkohshëm të agjencisë nuk ruan në hapësirat e punës në të cilat është regjistruar selia e agjencisë private për punësim dhe të punëdhënësit shfrytëzues (neni 26 paragrafi (3)),

- punëdhënësi shfrytëzues punëtorin e kaluar të përkohshëm të agjencisë e rikalon në punëdhënës tjetër shfrytëzues (neni 26 paragrafi (5) alineja 2 të këtij ligji),

- nuk paguan një faturë ndaj agjencisë private për punësim me licencë në afatin e përcaktuar në marrëveshjen për kalim (neni 28 i këtij ligji),

- nuk jep të dhëna të sakta të agjencisë private për punësim me licencë për punësime të përkohshme për lartësinë e rrogës bazë për vendin e punës ose ngjashëm me të nëse nuk ka vend të tillë pune në të cilin punon punëtori i përkohshëm agjencisë (neni 30 paragrafi (2) i këtij ligji),

- punëdhënësi shfrytëzues e vendos punëtorin e përkohshëm të agjencisë në pozitë të pabarabartë në pajtim me këtë ligj, ligj tjetër, marrëveshje kolektive dhe akt të punëdhënësit shfrytëzues (neni 31 paragrafi (3) alineja 3 të këtij ligji) dhe

- e prish marrëveshjen me agjencinë private për punësim me licencë përpunësime të përkohshme, para kalimit të afatit të përcaktuar në marrëveshje për shkak të mos pasjes nevojë për punëtor të përkohshëm të agjencisë të punëdhënësit shfrytëzues, përveç në rast të fuqisë madhore (neni 33 paragrafi (2) të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënës mikro dhe i vogël, 250 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënës i mesëm dhe 350 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënës i madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.”.

Neni 7

Neni 45 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël- person juridik, gjobë në shumë 500 deri 600 euro punëdhënësit të mesëm- person juridik, gjobë në shumë 800 deri 1000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh - person juridik, nëse:

- agjencia private për punësim me licencë për ndërmjetësim, dy muaj të njëpasnjëshëm ose tre muaj në vitin kalendarik, nuk dorëzon në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut të dhëna për personat të dërguar për punësim të mundshëm, në pajtim me nenin 38 të këtij ligji (neni 15 paragrafi (1) alineja 8 të këtij ligji),

- fillon të kryejë shërbime për ndërmjetësim për punësim pa nënshkruar marrëveshje për ndërmjetësim me punëdhënësin potencial në të cilin janë përcaktuar kushtet për punësim (neni 36 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji),

- kërkon ose arkëton kompensim për shërbimin për ndërmjetësim nga personi i dërguar për punësim të mundshëm (neni 34 paragrafi (2) të këtij ligji),

- ndërmjetësimin për punësim e kryen në kundërshtim me këtë ligj (neni 35 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial për ndërmjetësim për punësim në vendin në të cilin nuk janë rregulluar kushtet dhe mënyra për punësim me ndërmjetësim në vend (neni 36 paragrafi (2) të këtij ligji),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial në vend, i cili nuk i përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj (neni 36 paragrafi (3) të këtij ligji),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial për ndërmjetësim për punësim në të cilin nuk janë rregulluar kushtet dhe mënyra për punësim me ndërmjetësim jashtë vendit (neni 37 paragrafi (2) të këtij ligji),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial jashtë vendit, i cili nuk i përmban elementet e përmbajtura në këtë ligj (neni 37 paragrafi (3) të këtij ligji),

- nuk lidh marrëveshje për ndërmjetësim jashtë vendit me personin kërkues të punës, për përcaktim të ndërsjellë të të drejtave dhe detyrimeve ose marrëveshja nuk i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 37 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji),

- nuk siguron para-marrëveshje për punësim me punëdhënësin potencial të huaj, në pajtim me këtë ligj ose para-marrëveshjen nuk ia dorëzon për shikim kërkuesit të punës, me ofertë për nënshkrimin e tij dora vet (neni 37 paragrafi (6) të këtij ligji),

- nuk i paguan kompensim në pajtim me marrëveshjen për ndërmjetësim personit i cili dërgohet për punësim të mundshëm jashtë vendit (neni 37 paragrafi (8) të këtij ligji),

- i detyron personat e dërguar për punësime të mundshme te punëdhënësi potencial ta pranojnë punën e ofruar (neni 39 paragrafi (1) alineja 1 të këtij ligji),

- e detyron punëdhënësin potencial ta pranojë të punojë personin e dërguar për punësim të mundshëm (neni 39 paragrafi (1) alineja 2 të këtij ligji),

- shfrytëzon punën e fëmijëve gjatë ndërmjetësimit për punësim të mundshëm (neni 39 paragrafi (1) alineja 3 të këtij ligji),

- e shkel dinjitetin dhe moralin e personave të dërguar për punësim të mundshëm (neni 39 paragrafi (1) alineja 4 të këtij ligji) dhe

- në mënyrë të parregullt dhe jo në kohë i informon personat për punësime të mundshme për kushtet për punën e ofruar (neni 39 paragrafi (2) të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënësi mikro dhe i vogël, 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet te punëdhënësi i mesëm dhe 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet te punëdhënësi i madh.”.

Neni 8

Neni 46 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 150 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël-person juridik, gjobë në shumë 200 deri 400 euro punëdhënësit të mesëm-person juridik, gjobë në shumë 400 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh-person juridik, nëse:

- nuk dorëzon të dhëna në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri më datën pesë në muajin rrjedhës për muajin paraprak, për personat e dërguar jashtë vendit (neni 38 paragrafi (1) të këtij ligji) dhe

- nuk i ruan marrëveshjet për ndërmjetësim në pajtim me dispozitat për punë arkivore në hapësirat e punës në të cilat është regjistruar selia e agjencisë (neni 38 paragrafi (2) të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënësi mikro dhe i vogël, 250 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënësi i mesëm dhe 350 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënësi i madh.”.

Neni 9

Neni 47 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël-person juridik, gjobë në shumë 500 deri 600 euro punëdhënësit të mesëm-person juridik, gjobë në shumë 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh-person juridik, nëse:

- nënshkruan marrëveshje me agjencinë private për punësim, me licencë për ndërmjetësim në vend, në të cilën nuk janë përmbajtur kushtet për punësim me personin e dërguar për punësim të mundshëm dhe marrëveshja nuk i përmban elementet e nevojshme (neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji),

- nuk e informon agjencinë private për punësim me licencë për ndërmjetësim për rezultatin nga intervista për punësim me personin e dërguar për bisedim për punësim të mundshëm (neni 36 paragrafi (4) të këtij ligji),

- nuk lidh marrëveshjen personin e zgjedhur të dërguar për punësim të mundshëm (neni 36 paragrafi (5) të këtij ligji) dhe

- nuk ia paguan detyrimet kontraktuese, në pajtim me marrëveshjen për punësim, që e ka lidhur me personin e drejtuar për punësim të mundshëm (neni 36 paragrafi (7) të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik të punëdhënës mikro dhe i vogël, 300 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënës i mesëm dhe 400 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënës i madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik."

Neni 10

Neni 48 ndryshohet si vijon:

"(1) Gjobë në shumë prej 100 deri në 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit zyrtar nga organi i cili e menaxhon procedurën dhe organin kompetent publik nga i cili janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat, nëse:

- nuk i siguron dëshmitë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 5 paragrafi 2));

- nuk i siguron dëshmitë e kërkuara në pajtim me këtë ligj nga dita e pranimit të kërkesës së personi juridik është regjistruar në pajtim me ligjin dhe i plotëson kushtet tjera të përcaktuara me këtë ligj (neni 5 paragrafi (3) të këtij ligji) dhe

- nuk vendos sipas kërkesës në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të dokumenteve dhe dëshmimeve për plotësimin e kushteve për marrjen e licencës (neni 13 i këtij ligji)."

Neni 11

Neni 49 ndryshohet si vijon:

"(1) Procedurën kundërvajtëse për kundërvajtje nga nenet 42, 43, 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji e udhëheq edhe sanksion kundërvajtës shqipton komisioni kundërvajtës i cili është formuar nga ministri kompetent për çështje nga sfera e punës.

(2) Për kundërvajtje nga neni 48 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

(3) Realizimi i të drejtës për mjet juridik kundër vendimit të komisionit për kundërvajtje nga paragrafi (1) zbatohet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 12

Neni 50 ndryshohet si vijon:

"(1) Për kundërvajtje nga nenet 42, 43, 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji, inspektori kompetent, para se të parashtrijë kërkesë për inicim të procedurës për kundërvajtje është i obliguar personit përgjegjës apo personit të autorizuar nga ai t'i ofrojë procedurë për barazim, me lëshim të urdhërpagesës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e paguan gjobën në afat prej tetë ditëve nga dita e kalimit të urdhër pagesës për kundërvajtje, do ta paguajë gjysmën e gjobës në afat prej tetë ditëve nga dita e lëshimit të urdhërpagesës për kundërvajtje, do ta paguajë gjysmën e gjobës së paraparë, ndërsa nëse nuk e paguan në afatin e paraparë, personi i autorizuar do të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje në organin kompetent.

(3) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje e përcakton ministri e Punës dhe Politikës Sociale."

Neni 13

Neni 51 shlyhet.

Neni 14

Në gjithë tekstin e Ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 15

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 16

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për Agjenci Private për Punësim.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.